

PROCESVERBAL
nga mbledhja e 33-të e Këshillit të Agjencisë për
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
të mbajtur më datë 25.08.2022

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: m-r Dragica Ljubevska, m-r Emilija Janevska, m-r Magdalena Davidovska Dovleva, m-r Ruzhica Boshnakoska Jotevska, d-r Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 33-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u realizua në hapësirat e Agjencisë, në sallën e konferencave në katin e dytë.

Këshilli i Agjencisë miratoi si vijon:

R E N D D I T E

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 7-të Publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më datë 17.08.2022.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 32-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më datë 17.08.2022.
3. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj TV Iris nga Shtipi për shkelje të nenit 15 të Ligjit për media.
4. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare të Riodifuzionit TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkeljen e nenit 50 paragrafi 3 nga LSHMAA.
5. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkeljen e nenit 64 paragrafi 1 nga LSHMAA.
6. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkeljen e nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAA.
7. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkeljen e nenit 14 nga Ligji për media

8. Propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit TV K&M KISS&MENDADA SHPKNJP Tetovë për shkeljen e nenit 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor.
9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e seancës së 7-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 17.08.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e seancës së 32-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 17.08.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj TV Iris nga Shtipi për shkelje të nenit 15 të Ligjit për medime. Sqaroi se ky radiodifuzer edhe më tutje vazhdon që të funksionojë me probleme serioze dhe pothuajse çdo seancë është lëndë e shqiptimit të ndonjë mase nga ana e Këshillit. Këtë herë radiodifuzeri nuk e ka plotësuar obligimin nga neni 15 i Ligjit për medime, respektivisht ne programin e vet nuk i publikon të dhënat e strukturës pronësore, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe burimet e financimit gjatë vitit të kaluar (reklammat, sponsorimet, shitjen e përmbajtjeve, shërbime të siguruar nga palë të treta, etj.) si dhe nuk ka dorëzuar te Agjencia incizim të publikimit në afatin prej 15 ditëve nga dita e publikimit. Për këtë arsye propozohet që të shqiptohet masa e vërejtjes publike.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt administrative, nr. 03-2919/1 nga data 25.07.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip të shqiptohet masa e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 15 paragrafi 3 nga ligji për medime, sepse në afatin e dytë të paraparë nuk i ka publikuar në programin e vet, të dhënat e strukturës pronësore, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe burimet e financimit gjatë vitit të kaluar (reklammat, sponsorimet, shitjen e përmbajtjeve, shërbime të siguruar nga palë të treta, etj.) si dhe nuk ka dorëzuar te Agjencia incizim të publikimit në afatin prej 15 ditëve nga dita e publikimit.

Në pajtim me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (teksti i spastruar) nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, u urdhëruar që në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, ta harmonizojë punën sipas dispozitave të Ligjit për media.

Spektori për Çështje Juridike dhe furnizime publike e përgatiti aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Spektori për Planifikim Strategjik dhe Mbrojtjen e të Drejtave Autoriale, pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje

kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, e ka publikuar të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

Pikët 4, 5, 6 dhe 7

Z. Petrushevski sqaroi se Pikat 4,5,6 dhe 7 kanë të bëjnë me të njëjtin medium por për shkelje të ndryshme të Ligjit. Pyeti nëse shkeljet janë të konstatuara gjatë mbikëqyrjes së njëjtë, për çka shërbimi u përgjigj se konstatimet janë nga një mbikëqyrje e realizuar më datë 4 korrik 2022. Në këtë drejtim, propozoi që të jepet një hyrje dhe diskutim i përbashkët për pikat, ndërsa votimi të bëhet ndaras për secilën shkelje.

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, m-r Emilija Janevska i arsyetoi propozimet për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 50 paragrafi 3, nenit 64 paragrafi 1, nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAA dhe për shkak të shkeljes së nenit 14 të Ligjit për media. Sqaroi se me mbikëqyrjen e rregullt programore, të realizuar në korrik te TV Shutel janë konstatuar disa shkelje. E para ka të bëjë me rregullat për mbrojtjen e të miturve. Është konstatuar se një bllok i filmave të animuar për fëmijë nga producenti “Worner bros” dhe dy episode të programit arsimor-argëtues “Islamsko serija” ishin emetuar pa sinjalizim paralajmërues adekuat dhe pa u klasifikuar në kategorinë përkatëse të programeve, ndërsa para fillimit të filmit artistik “Xhosh i Sem” nuk ishte aplikuar sinjalizimi paralajmërues adekuat. Për këtë arsye propozohet shqiptimi i masës së vërejtjes publike me afat për harmonizim prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit e më pas të realizohet një mbikëqyrje kontrolluese për të parë nëse është bërë harmonizimi ligjor. Shkelja e dytë, Pika 5 është për nenin 64 të LSHMAA dhe ka të bëjë me obligimet për gjuhën e emetimit të programit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se janë emetuar filma artistik në gjuhën burimore angleze, pa siguruar përkthim në gjuhën rome ose maqedonase, gjuhët në të cilat mediumi emeton program sipas lejes, ndërsa po ashtu nuk është siguruar as përkthim nga gjuha kroate në gjuhën rome ose maqedonase në hulumtimet e Tereza Kesovijas dhe Severina në incizimet e emetuara nga koncertet e tyre në programin e TV Shutel. Për këtë arsye propozohet shqiptimi i masës së vërejtjes publike me afat prej 15 ditëve për harmonizim, pas pranimit të aktvendimit, e më pas të realizohet mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse është harmonizuar me ligjin. Në lidhje me shkeljen e tretë, Pika 6, u tha se ka të bëjë me nenin 92 paragrafi 1 nga LSHMAA, respektivisht radiodifuzeri ka emetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase. Për këtë arsye propozohet shqiptimi i masës së vërejtjes publike me afat prej 30 ditëve për harmonizim, nga dita e pranimit të aktvendimit e më pas të realizohet mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse është harmonizuar me ligjin. Shkelja e fundit ka të bëjë me nenin 14 të Ligjit për media, respektivisht në një pjesë të programeve të emetuara nuk i ka publikuar të dhënat për impresum që është i obliguar për t'i emetuar në vendin përkatës për secilën përmbajtje të shërbimit programor. Edhe për këtë shkelje propozohet shqiptimi i masës së vërejtjes publike me afat prej 45 ditëve për harmonizim, nga dita e pranimit të aktvendimit e më pas të realizohet mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse është harmonizuar me ligjin.

votimi për Pikën 4

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt administrative, nr. 10-2931/1 nga data 25.07.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 50 paragrafi 3 nga LSHMAA dhe të nenit 19 nga Rregullorja për mbrojtjen e të miturve, sepse më datë 4 korrik 2022, në një bllok i filmave të animuar për fëmijë nga producenti "Eörner bros" si dhe dy episode të programit arsimor-argëtues "Islamsko serija" janë emetuar pa sinjalizim paralajmërues përkatës dhe pa u klasifikuar në kategorinë e përkatëse të programeve, ndërsa para fillimit të filmit artistik "Xhosh i Sem" nuk është aplikuar sinjalizimi paralajmërues adekuat.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, Shoqëria Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, obligohet që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit për shqiptimin e masës së vërejtjes publike, ta harmonizojë punën e vet sipas nenit 50 paragrafi 3 nga LSHMAA dhe të nenit 19 nga Rregullorja për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për Çështje Juridike dhe furnizime publike duhet ta përgatis aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Spektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

votimi për Pikën 5

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt administrative, nr. 10-2864/1 nga data 19.07.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 64 paragrafi 1 sepse më datë 4 korrik 2022 janë emetuar filma të vizatuar në gjuhën burimore angleze, pa siguruar përkthim në gjuhën rome ose maqedonase, gjuhët në të cilat mediumi emeton program sipas lejes, ndërsa gjithashtu nuk është siguruar as përkthim nga gjuhën kroate në gjuhën rome ose maqedonase në hulumtimet e Tereza Kesovijas dhe Severina në incizimet e emetuara nga koncertet e tyre në programin e TV Shutel.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (teksti i spastruar) nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, obligohet që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit ta harmonizojë punën me dispozitat e nenit 64 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike dhe furnizime publike ta përgatis aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Sektor i për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektor i për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për Pikën 6

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt administrative, nr. 10-2863/1 nga data 19.07.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAA, sepse në korrik të vitit 2022, nuk ka emetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor me vepra audiovizuale maqedonase.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (teksti i spastruar) nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, obligohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, ta harmonizojë punën me dispozitat e nenit 92 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Sektor i për Çështje Juridike dhe furnizime publike ta përgatis aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Sektor i për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektor i për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

votimi për Pikën 7

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt administrative, nr. 10-2929/1 nga data 25.07.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 14 nga Ligji për media, sepse më 4 korrik të vitit 2022, në një pjesë të programeve të emetuara nuk i ka publikuar të dhënat e impresumit që është i obliguar për emetim, në vend përkatës për secilën përmbajtje të shërbimit programor në veçanti.

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (teksti i spastruar) nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, obligohet që në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, ta harmonizojë punën me dispozitat e Ligjit për media.

Sektor i për Çështje Juridike dhe furnizime publike ta përgatis aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Sektor i për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyruar (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektor i për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit TV K&M KISS&MENDADA SHPKNJP Tetovë për shkeljen e nenit 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor. Ai sqaroi se ky radiodifuzer gjatë fushatës zgjedhore disa herë e që është prezantuar në tabelë me materialet e parashtruara, i ka tejkaluar limitet e lejuara për reklamim të paguar politik edhe atë për disa parti politike, LSDM, VMRO-DPMNE dhe LEVICA. Në pajtim me Kodin Zgjedhor propozohet që të iniciohet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar për prezantim të mediatik zgjedhor nr. 10-3240/1 nga data 24.08.2022 të Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit TV K&M KISS&MENDADA SHPKNJP Tetovë ku konstatoi shkelje të nenit 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor.

Këshilli njëzëri konstatoi që kundër SHTR K&M KISS&MENDADA SHPKNJP Tetovë të iniciohet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse me mbikëqyrjen është konstatuar se ky radiodifuzer në kundërshtim me nenin 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, më date 12, 16, 17 dhe 18 gusht 2022, në disa orë reale të programit të emetuar ka ndarë më shumë se 4 minuta për reklamim të paguar politik për kandidatët e Këshillit të Komunës së Tetovës, prej dy partive më të mëdha të pozitës (Koalicioni MË E MIRA PËR KOMUNËN TIME të udhëhequr nga LSDM) më shumë se 4 minuta për reklamim të paguar politik për kandidatët e Këshillit të Komunës së Tetovës për njërin prej dy partive më të mëdha të opozitës (VMRO-DPMNE) dhe më shumë se 1 minutë për reklamim të paguar politik për një parti politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë e cila në zgjedhjet e fundit për deputetë, nuk morri mjaftë deputetë për të formuar grup të deputetëve (Partia politike - LEVICA).

Sektor i për Çështje Juridike dhe furnizime publike ta përgatis Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Pika 9

Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutim.

Nr. 02-3223/8
06.09.2022

Shkup

Agjencia për shërbime Mediatike
audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v